
Gjatë muajve Prill-Qershor, janë shqyrtuar gjithsejt **535** ankesa dhe të gjitha kanë përfunduar me eliminimin e defekteve të ndryshme.

Në rrjetin e ujësjellësit janë bërë **425 aktivitete, ndërsa në rrjetin e kanalizimit **138** raste.*

Gjithsej aktivitete në ujësjellës Prill-Qershor			
1	Defektet në rrjetin sekondar	276	defekte
2	Defektet në rrjetin primar	67	defekte
3	Defekte në komplet rrjetin	343	defekte
4	Bartja e ujit me cistern	16	m ³
5	Pastrimi dhe fryerja me kompresor	29	raste
6	Rregullimi i rruges	65	m ²

Gjithsej aktivitete në kanalizim Prill-Qershor			
1	Kontroll i pusetes	296	copë
2	Pastrim i pusetes	179	copë
3	Kontroll i kanalizimi	6179	metra
4	Pastrim i kanalizimi	3663	metra
5	Ndërrim i pusetes	0	copë
6	Ndërrim i kanalizimi	16	metra
7	Riparim i rruges	0	m ²

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjenik Regjional janë në baz të raporteve mujore.

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).
- Marrja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- Marrja e mostrave **Fiziko-Kimike**
- Marrja e mostrave **Bakteriologjike**

Aktivitetet mujore Prill-Qershor, 2016 - Njesia Suharekë

* *Furnizimi me ujë, Prill-Qershor* – ka pasur disa ndërprerje të furnizimit me ujë në pjesët e larta të qytetit, deri sa është bërë vendosja e pompës në Baqevc dhe në S.T Pusi i Atit, në fshatit Samadraxhë është aplikuar reduktimi i ujit të pijes gjatë natës (20:00-06:00) në mungesë të kapacitetit të pompës transportuse(rez.1-rez.2) dhe kapacitetit të vogël njëri nga të tre puset si dhe pas rritjes së temperaturave proporcionalisht është rritur edhe kërkesa e ujit të pijes, dhe si kompani jemi detyruar që në pjesët periferike të qytetit të aplikojmë reduktime të furnizimit me ujë(21:00-07:00). Në fshatrat Sopi(09:30-13:00), Reshtan(18:00-06:00), Gjinoc(09:00-14:00) dhe Sallagrazhdë(21:00-06:00) kemi bërë reduktime të ujit që të kemi një shpërndarje te përafërt të ujit në të gjitha pikat e qytetit dhe fshatrave.

* *Analizat e ujit, Prill-Qershor* – janë bërë 18 mostra të ujit të pijes nga Institutit i Shëndetit Publik, të cilave të gjitha i përgjigjen standardeve (ISHP).

* *Rregullimi i defekteve, Prill-Qershor* - janë riparuar gjithsejt 2 defekte në gypat kryesor, 75 defekte në gypat e kyçjes së ujësllësit dhe 34 deblokime të kanalizimeve.

* *Nxjerrja e pompës 7,5 kW nga pusi nr. 3* - është bërë nxjerrja e pompës 7,5 kW, e cila nga janari 2012, ka qenë e zhytur komplet në pus, dhe si pasoj e kësaj pusi ka qenë jo funksional. Me nxjerrjen e kësaj pompe, është riaftësuar pusi dhe është bërë shtimi i sasisë së ujit për fshatin Samadraxh (4 l/s).

* *Fillimi i punimeve“Rehabilitimi i Burimit të Ujit në fshatin Peqan“* - punimet kanë filluar në fund të muajit Prill, dhe ekipi i mirëmbajtjes së kompanisë tonë e ka bërë vendosjen e gypit të përkohshëm (90 mm) prej burimit deri në gypin ekzistues për në rezervuar, që të mos e ndërprejë furnizimin me ujë për banorët e fshatit në fjalë, deri sa të bëhet rehabilitimi i burimit dhe vendosja e gypit të ri nga kaptazha deri te rezervuari ekzistues.

* *Vazhdimi i punimeve “ Rehabilitimi i Burimit të Ujit në fshatin Peqan “* - punimet kanë vazhduar, me hapjen e kanalit për shkarkimin e ujit dhe vendosja e gypit Ø 500 mm të brinjëzuar SN4 me gjatësi L=90m. Ekipi i operativës ka bërë vendosjen e pompave dhe testimin e prurjes së burimeve, nga çka është konstatuar se burimi i vetëm-kryesorë është brenda galerisë ndërsa burimet jasht galerisë janë të ndikuar direkt nga burimi kryesorë brenda. Gjatë tërë muajit pompa 3.8 kW ka funksionuar dhe ka dërguar ujë për rezervuarin e fshatit Peqan.

* *Pastrimi i rezervuarëve* - është bërë pastrimi i hapësirës rreth rezervuarit kryesorë në Shirokë dhe në fshatin Samadraxhë është bërë pastrimi dhe kositja e barit te stacioni i Pompave.

Aktivitetet mujore Prill-Qershor, 2016 – Njesia Malishevë

Furnizimi me ujë, *Prill-Qershor* - ka qenë i mirë por me reduktime ne keto fshatra: Carralluke, Drenovc, si dhe ne pikat me te larta ne fshatin Baje dhe ne Malisheve, pershkak te ngritjes se kerkesave per uje si dhe rritjes se temperaturave .

* *Analizat e ujit, Prill-Qershor* - janë realizuar 15 mostra të analizave bakteriologjike dhe 15 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve një nuk i përgjigjet standardeve (ISHP).

**Aktivitetet lobimi* - kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, atë të Urbanizimit si dhe me Drejtorin e Financave, kontakte me zyrtarët e KEDS-it për montimin e rrjetit elektrik në fsh. Senik deri te stacioni i pompave.

**Rregullimi i defekteve, Prill-Qershor* - rrjeti primar 40 defekte, rrjeti sekondar 70 defekte, deblokimi i kanalizimeve 13 ndërhyrje dhe 1.3 km kanal të pastruar, njoftime për shkyqje 111, ujëmatësia të ndërruar 25, ujëmatësia të montuar 24, ankesat teknike 24, ankesat komerciale 25, kyqje ilegale 3, rikyqje 1, kyqje të reja 28, amvisëri 23, lokale 5, procesverbale të shkyqjeve 48, verifikim të ujëmatësive 346, riprogramim të borgjit kontrata 30.

Aktivitetet mujore Prill-Qershor, 2016 - Njesia Dragash

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë muajve Prill-Qershor, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është pastruar edhe kaugullatori.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

*Aktivitetet nga ekipi teknik, në operativë janë bërë këto: 16 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 6 kyqje në rrjetin e ujësjellësit, 14 ndrrime të ujëmatsave, 45 pastrim dhe kontrole të ujëmatsave, 7 montim i ujëmatesit të ri, 5 sanime në rrjetin e kanalizimit, 75 m. deblokime në rrjetin e kanalizimit, 10 pastrime të pusetave të kanalizimit, 22 angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshirë punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

*Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

*Prodhimi i ujit: në këtë muaj janë prodhuar 68,600.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

*Humbjet e ujit: humbjet e ujit këtë muaj arrijnë rreth 50.30 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.1 Aktivitetet

Është bërë leximi i ujëmatësve nga Inkasantët (lexuesit) e terrenit .

- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellësit mbrenda afatit ligjor të secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellësit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve
- Janë shpërnda njoftime për mospagesë të shërbimeve të ujësjellësit të konsumatorët të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha.
- Janë bërë kontrole në teren të konsumatorët nga ekipet e kontrollës për mospagesë të borxheve, lidhje jashtë ujëmatësit dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.
- Ka vazhdu shqyrtimi i kërkesave për falje të borxhit në secilën njësi të KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha

- Është përgadit dhe ka fillu aplikimi i normës së re mbi normimin e punëve të inkasantëve në secilën njësi të KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha

Raport nga falje e borxheve – 01.10.2015 – 20.07.2016

*

Njesia	Nr Konsumatoreve	Nr Kontratave	Shuma Kontraktuar	Shuma e Inkasuar	Shuma e Falur
DRAGASH	165	165	11,634.95	4,769.30	41,159.13
MALISHEV	179	169	40,622.12	5,281.64	20,094.17
PRIZREN	3238	3184	281,824.16	177,391.94	770,725.00
SUHAREK	150	159	26,716.91	4,780.18	29,261.30
Total	3,732	3,677	360,798.14	192,223.06	861,239.60

2. Raportimi i rasteve të proceduara te përmbaruesi privat.

Gjatë muajit maj, qershor dhe deri me sot tek përmbaruesi janë dërguar lëndët si më poshtë:

- Me datën 13.05.2016-16 lëndë
 - Me datën 27.05.2016-16 lëndë
 - Me datën 14.06.2016-13 lëndë, njësia e Malishevës
 - Me datën 29.06.2016- 10 lëndë
 - Me datën 19.07.2016- 1 lëndë
- Totali= 56 lëndë të proceduara te përmbaruesi.

Të përgaditura janë edhe:

- 20 raste të njësisë së Prizrenit (kryesisht biznese),
- 14 konsumatorë të njësisë së Malishevës (konsumatorë nga fashti Lumnishtë dhe Banjë) dhe
- 7 konsumatorë nga njësia e Suharekës
(ne total 41 raste).

3.2 Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes TM1-2015- TM1- 2016

TM1- 2016

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	221	4	2	1837	37,328.72
2	Suharekë	14	5	2	670	3,219.00
3	Malishevë	147	33	10	840	7,731.76
4	Dragash	0	0	0	0	0.00
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	382	42	14	3347	48,279.48 €

TM2- 2016

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	112	0	3	1522	97.00
2	Suharekë	39	7	25	1371	8.565,60
3	Malishevë	140	20	10	840	3,731.76
4	Dragash	0	0	0	0	0.00
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	191	27	38	3733	12.584.76

- Gjate TM2 2016 janë pranuar 564 ankesa në total, prej tyre 360 ankesa teknike (+ 54) dhe 204 ankesa komerciale. (+ 42), Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në pajtim me procedurat e mbrendshme te Kompanisë, te ankesat komerciale konsumatorët kanë marr përgjigje me shkrim nga komisioni i cili ka shqyrtuar këto ankesa.

TM1- 2016- Ankesat teknike dhe komerciale

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	306
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	306
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	162
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	162
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	162
Total		468

TM2- 2016- Ankesat teknike dhe komerciale

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	360
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	358
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	204
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	204
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	204
Total		564

3.3 PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

- Mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale , kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve.
- Pamundësia e leximit të ujëmatsve për çdo muaj te një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për tui mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht te konsumatorët që jetojn në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kan qenë nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Pronës.
- Borxhet e ndërmarrjeve të Privatizuara, të cilat refuzohen si borxhe nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Borxhet të cilat janë pranuar , ende nuk është bërë pagesa e tyre pasi që pritet procesi i Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve.

3.4 MASAT E REALIZUARA/ MOSREALIZUARA NGA TREMUJORI PARAPRAK

- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në faljen e borxheve
 - Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
 - Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
 - Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojn të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit

3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR MUAJT E ARDHSHËM

- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në faljen e borxheve
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
 - Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
 - Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojn të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit

3.6. RAPORT I MEDIAVE

PRILL

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	05.04.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT NË DISA LAGJE, PËR SHKAK TË SANIMIT TË DEFEKTIT
2	05.04.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT NË DISA RRUGË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE NË IMPLEMENTIMIN E KOLEKTORIT TË UJËRAVE TË ZEZA
3	05.04.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	ARTIKULLI: REDUKTIME TË FURNIZIMIT ME UJË NË DISA RRUGË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE NË IMPLEMENTIMIN E KOLEKTORIT TË UJËRAVE TË ZEZA
4	05.04.2016	www.kosova-info.com	ARTIKULLI: NESËR DISA LAGJE TË PRIZRENIT, NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
5	05.04.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: NESËR DISA LAGJE TË PRIZRENIT, NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
6	05.04.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: PUNIMET NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ", NDIKOJNË QË QENDRA E QYTETIT TË PRIZRENIT MOS TË FURNIZOHET ME UJË
7	05.04.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: REDUKTIMET E UJIT NDODHIN PËR SHKAK TË PUNIMEVE NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ"
8	13.04.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NJËSIA SUHAREKË- NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË PUNIMEVE TË KEDS-it
9	13.04.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: PUNIMET E KEDS-it SHKAKTARË PËR NDËRPRERJE TË UJIT NË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS
10	19.04.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: LLOKVICA BËHET ME IMPIANT PËR TRAJTIM BIOLOGJIK UJËRASH TË ZEZA
11	20.04.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: PUNIMET NË RRUGË U SHKAKTOJNË PROBLEME QYTETARËVE
12	20.04.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: PUNIMET NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ", U SHKAKTOJNË PROBLEME QYTETARËVE
13	20.04.2016	www.rtklive.com	ARTIKULLI: MALISHEVË- PROJEKTOHET RRJETI I UJËSJELLËSIT PËR 14 FSHATRA
14	20.04.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: BRENDË VITIT PËRFUNDON NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT PËR 14 FSHATRA TË MALISHEVËS
15	20.04.2016	www.malishevapress.com	ARTIKULLI: NË MALISHEVË PARASHIHET T TË PËRFUNDOJ PROJEKTI I UJËSJELLËSIT PËR 14 FSHATRA
16	21.04.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: BRENDË VITIT PËRFUNDON NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT PËR 14 FSHATRA TË MALISHEVËS

17	27.04.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: RRUGA " REMZI ADEMAJ" E BLOKUAR DERI ME 13 MAJ
18	27.04.2016	TV-OPINION	PRONONCIM RRETH PUNIMEVE NË RRUGËN " REMZI ADEMAJ"
19	28.04.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: SHTYHEN PUNIMET NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ" NË PRIZREN
20	28.04.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: SHTYHET DERI ME 13 MAJ AFATI I PUNIMEVE NË RRUGËN " REMZI ADEMAJ"
21			

MAJ

NR	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	05.05.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA MALISHEVË- NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË RRJETIN DISTRIBUTIV TË KEDS-it.
2	06.05.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM LIDHUR ME MASAT QË DO TË APLIKOHEN NDAJ KONSUMATORËVE QË NUK I SHLYEJNË BORXHET NDAJ KRU"HIDROREGJIONI JUGOR"
3	09.05.2016	RADIO HELIX	EMISION I MËNGJESIT- DISKUTIM RRETH FALJES SË BORXHEVE
4	10.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	EMISION I MËNGJESIT- DISKUTIM RRETH FALJES SË BORXHEVE
5	14.05.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: KALON AFATI, PUNIMET NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ" NUK PËRFUNDOJNË
6	14.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: EDHE PAS AFATIT SHITESË, PUNIMET NË RRUGËN"REMZI ADEMAJ" NUK PËRFUNDOJNË
7	16.05.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA RRUGË, PËR SHKAK TË PARAQITJES SË DEFEKTIT
8	16.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: DALIN PROBLEME TË REJA NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ", SHUMË LAGJE TË PRIZRENIT MBESIN PA UJË
9	16.05.2016	TELEVIZIONI OPINION	ARTIKULLI: DALIN PROBLEME TË REJA NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ", SHUMË LAGJE TË PRIZRENIT MBESIN PA UJË
10	16.05.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: PUNIMET E KOLEKTORIT NË RRUGËN "REMZI ADEMAJ", LËNË PA UJË DISA LAGJE TË QYTETIT
11	17.05.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: NJË PJESË E PRIZRENIT PA UJË, SHKAKU I PUNIMEVE NË KOLEKTOR
12	17.05.2016	www.koha .net	ARTIKULLI: NJË PJESË E PRIZRENIT PA UJË, SHKAKU I PUNIMEVE NË KOLEKTOR
13	20.05.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: DINAMIKA E PUNIMEVE PËR KOLEKTORIN, NXIT REAGIMIN E KËSHILLTARËVE KOMUNAL
14	21.05.2016	RADIO KOSOVA	EMISION - MËNGJESI EKOLOGJIK
15	21.05.2016	RTK	PRONONCIM RRETH FALJES SË BORXHEVE

16	25.05.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: JEPET NË SHFRYTËZIM PRONA PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT 23 MILIONË EURO
17	27.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: PROBLEME ME UJIN E PIJES, BANORËT E LAGJES "BAZH DARHANE" PROTESTOJNË TË HËNËN PARA OBJEKTIT TË KOMUNËS NË PRIZREN
18	29.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONIT" I JEPET NË SHFRYTËZIM PRONA E SHPRONËSUAR NË VLASHNJE
19	29.05.2016	TELEVIZIONI OPINION	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONIT" I JEPET NË SHFRYTËZIM PRONA E SHPRONËSUAR NË VLASHNJE
20	29.05.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: NESËR PROTESTOHET NË PRIZREN
21	30.05.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONIT" I JEPET NË SHFRYTËZIM PRONA E SHPRONËSUAR NË VLASHNJE
22	30.05.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: NË PRIZREN PROTESTOHET PËR UJË TË PIJSHËM
23	30.05.2016	www.indeksonline.net	ARTIKULLI: NË PRIZREN PROTESTOHET PËR UJË TË PIJSHËM
24	30.05.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: SOT NË PRIZREN PROTESTOHET PËR UJË TË PIJES
25	30.05.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: BANORËT E BAZHDARHANES NË PRIZREN, KËRKOJNË FURNIZIM TË RREGULLT ME UJË
26	30.05.2016	www.koha.net	ARTIKULLI: BANORËT E BAZHDARHANES NË PRIZREN, KËRKOJNË FURNIZIM TË RREGULLT ME UJË
27	30.05.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: PROTESTUAN PARA OBJEKTIT TË KOMUNËS , BANORËT E LAGJES "BAZH DARHANE"
28	30.05.2016	KLAN KOSOVA	ARTIKULLI: PRIZRENASIT PROTESTOJNË PËR SHKAK TË PROBLEMEVE ME UJË
29	31.05.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: BANORËT E "BAZH DARHANES" ME PROTESTË KUNDËR REDUKTIMEVE TË UJIT
30	31.05.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: BANORËT E BAZHDARHANES NË PRIZREN, KËRKOJNË FURNIZIM TË RREGULLT ME UJË

QERSHOR

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	16.06.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: UJI I PAFATURUAR - SFIDA E UJËSJELLËSIT TË PRIZRENIT
2	23.06.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË - APEL PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË UJIT DHE ORARI I REDUKTIMEVE
3	23.06.2016	RTV BESA	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR" APELON PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË UJIT, POR EDHE FILLON REDUKTIMET

4	23.06.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: RRIETET KONSUMI I UJIT NË SUHAREKË, HIDROREGJIONI APELON PËR SHFRYTËZIM RACIONAL, POR EDHE FILLON REDUKTIMET
5	23.06.2016	TELEVIZIONI OPINION	ARTIKULLI: RRIETET KONSUMI I UJIT NË SUHAREKË, HIDROREGJIONI APELON PËR SHFRYTËZIM RACIONAL, POR EDHE FILLON REDUKTIMET
6	24.06.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: BASHKË ME VAPËN, VIJNË EDHE REDUKTIMET E UJIT

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

4.1.1 Aktivitetet TM2- 2016

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrë me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet, Vendimet, Konstatimet dhe Konkluzionet e dala nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Kompanisë, Komisioni i Auditimit, Komiteti i Financave, Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Staf dhe Shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Shërbimi juridik ka përgatitur Kontratat në mes të Kompanisë dhe palëve të treta nga lëmia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim për të punësuarit e Kompanisë i ka lëshuar të gjitha llojet e Aktvendimeve, Autorizimeve dhe Vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës sipas kërkesave të punëtorëve.
- Në pajtim me Ligjin e Punës për punëtorët të cilët kanë punuar jashtë orarit të punës janë lëshuar Aktvendime lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista e pagave të Zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve të tjerë.
- Në MZHE e kemi dërguar një Kërkesë lidhur me sqarimet se kush do ti mbuloj shpenzimet e ujit për Objektet e Kultit, gjithashtu e kemi dërguar edhe një Kërkesë për sqarime lidhur me Vendimin e BD për pagesën sipas mbulueshmërisë operative të Njësive Punuese, si dhe një Kërkesë lidhur me zgjidhjen e problemit për qiranë e objektit të administratës së Kompanisë.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista (tabela) për shpenzimet e bëra me rastin e vizitës studimore të impiantit të ujërave të zeza në qytetet Korçë dhe Pogradec të Shqipërisë.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit dhe financave, dhe në GIS. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësve nga shërbimet përkatëse.

Aktivitetet gjatë muajit PRILL 2016

- Sipas kërkesave të dërguara janë pranuar **3 (tre)** punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike

- Nga **3 (tre)** punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike, **1 (një)** është me aftësi të kufizuara, me çka Kompania jonë vazhdon të përmbushë kërkesën e parashtruar nga Qeveria e Kosovës lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Dy punëtorë nga Njësia Punuese Dragash kanë kaluar në Njësinë Punuese në Prizren.
- Punëtori nga Njësia Punuese Suharekë me pozitë të punës Inkasant – G.K. ka dhënë dorëheqje me vet dëshirë me date 05.04.2016.
- Gjate muajit Prill është shpallur një konkurse për dy Pastruese, një për Njësinë Punuese të Prizrenit dhe një për Njësinë Punuese të Suharekës.
- Janë bërë edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.

Aktivitetet gjatë muajit MAJ 2016

- Sipas Kërkesave të dërguara janë pranuar në punë 2 (dy) punëtorë me Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Me datë 08.05.2016 është pensionuar një punëtorë e Njesisë Punuese në Prizren.
- Me datë 23.05.2016 është bërë shpërbërja e kontratës për punonjësin M.K. – Kujdestar- Rojtar në 40 Burime në Njësinë Punuese të Prizrenit i cili ka qenë në Suspendim të përkohshëm nga data 23.11.2015.
- Gjate muajit Maj ka pas ndërrime të koeficienteve të punonjësve sipas kërkesave të parashtruara nga mbikëqyrësit e tyre.
- Me datë 17.05.2016 është shqiptuar masa disiplinore Suspendim i përkohshëm për punonjësin I.A.
- Kemi bërë vazhdimin e kontratave të punës për disa punëtorë.
- Janë bërë edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.

Aktivitetet gjatë muajit QERSHOR 2016

- Sipas Kërkesave të dërguara janë marrë 2 (dy) punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike.
- Ne Njësinë Punuese të Suharekës, rikthehet në punë punonjësi I.G. me pozitë të punës Vozitës i makinave të rënda.
- Ne muajin Qershor në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, i kemi pranuar në cilësinë e Praktikantëve 2 (dy) praktikant, me Marrëveshje për Trajnim në Punë, ku sipas kësaj marrëveshjeje për muajin e parë do të paguhet nga Kompania, ndërsa muajt e ardhshëm të njëjtit do të paguhet nga MPMS-ja.
- Me datë 16.06.2016 sipas Kërkesës së Sekretares së Kompanisë e cila gjendej në Pushim pa pagesë, i është ndërprerë pushimi pa pagesë dhe e njëjta e fillon pushimin e lehonisë.
- Brenda muajit Qershor Zyrtarja për Resurset Njerëzore të Kompanisë e ka zëvendësuar Asistenten e K-së, për kohën sa e njëjta ka qenë në pushim vjetor.
- Janë bërë edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.

4.1.2 PERSONELI – TM2- 2016

TM1-2016

Muajt	Nr.i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	308	3			2
Shkurt	311	3			3
Mars	315	4	1	1	2

TM2-2016

Muajt	Nr.i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Prill	316	1	1		2
Maj	317	1	1	1	
Qershor	318	1			2

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: QERSHOR – 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	265	36	6	11	318
Numri i Punëtorëve në %	83.3	11.3	1.9	3.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	42	13.21	
MESHKUJ:	276	86.79	
TOTAL	318	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QERSHOR 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla filllore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetorëve	32	28	0	200	1	52	5	318
Kualifikimi në %	10.06	8.81	0.00	62.89	0.31	16.35	1.57	

PËRFAQËSIMI NË GJYKATA
PRILL – QERSHOR 2016

	Seanca pergatiore	Seanca kruesore	Seancat e shtyra
Prill	2	3	1
Maj	1	/	2
Qershor	1	1	1
Totali	4	4	4

- Nga Gjykatat për periudhën kohore Prill - Qershor 2016, në total kanë ardhur **64 (gjashtëdhjetë e katër)** lëndë.

- Për **13 (trembëdhjetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë **Vendime** në favor të Kompanisë sonë.
- Për **3 (tri)** lëndë Gjykata ka marrë **Vendime** kundër Kompanisë sonë.

Gjykata i ka drejtuar **7 (shtatë) Kërkesa** Kompanisë sonë me të cilat kërkon që ti ipen informata shtesë lidhur me adresat e konsumatorëve, ku ne në afatet optimale i kemi dërguar njoftimet tona.

- Nga Gjykata Themelore në Prizren, janë sjellë **6 (gjashtë)** Konkluzione ku kërkohet që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtyre Konkluzioneve, gjykatës ti dërgojmë faturat origjinale për periudhën kohore të paditur nga ne për debitorët, e që në të kundërtën gjykata do të konsideron se është hequr dorë nga propozimi për përmbarrim, ku ne në afatet optimale i kemi dërguar njoftimet tona.

- Gjykata i ka parashtruar **12 (dymbëdhjetë)** Konkluzione për marrjen e informatave nga ne për gjendjen e borxheve të cilat i kanë këta konsumatorë konform Ligjin Nr. 05/L – 043 mbi Faljen e Borxheve Publike, ku në afatin e kërkuar nga Gjykata neve jemi përgjigjur.

- Si pasojë e vdekjes së **1 (një) Konsumatori** Gjykata ka marrë **Vendim** sipas të cilit kjo çështje pushohet.

- 1. Është parashtruar **1 (një) ANKESË** nga një Konsumatorë sipas së cilës personi ndaj të cilit kërkohet borxhi tanimë ka vdekur, andaj nga Gjykata kërkohet që në mungesë të legjitimitetit pasiv propozimi për përmbarrim i ushtruar nga kreditori të hedhet poshtë si i palejuar. Gjykata për këtë rast ka vendosur në favor të Kompanisë sonë dhe Ankesën e Konsumatorit e ka hedhur poshtë si të pabazuar.

4.1.3 RAPORTI I PUNËVE TE KRYERA NE GJYKATA TM2-2016

	Propozime për ekzekutime	Prapësime nga konsumatorët	Përgjigje në prapësime të konsumatorëve	Marrëveshje për pagesën e borxhit	Ankesa për Gjykatën e Apelit	Përgjigjet në Ankesa për Gjykatën e Apelit	Vendimet e marra nga Gjykata e Apelit	Totali i lëndëve të kryera
Prill	/	/	/	/	/	/	/	/
Maj	36	2	2	2	/	/	/	42
Qershor	23	/	/	6	2	2	/	33
Totali	59	2	2	8	2	2	/	75

Në tabelë janë paraqitur punët të cilat janë kryer me Përmbaruesin Privat, ku siç shihet në total i kemi dërguar 59 (pesëdhjetë e nëntë) lëndë me propozim për ekzekutim, nga të cilat 8 (tetë) konsumatorë kanë lidhur marrëveshje me Kompaninë për pagesën e borxhit të propozuar për përmbarim.

Nga Kompania jonë është përpiluar Prapësim ndaj Kompanisë Radoniqi Gjakovë.

VENDIMET E KOMPANISË NË ANKESAT DHE KËRKESAT E KONSUMATORËVE

Gjatë tremujorit të dytë të këtij viti nga Kompania jonë janë lëshuar gjithsej 87 (tetëdhjetë e shtatë) Vendime të cilat kanë të bëjnë me përgjigjet e dhëna në kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve.

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Prill	43	
Maj	22	
Qershor	22	
Totali	87	

Kryerja e punëve nga ana e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për muajin Prill, 2016

* Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njësisë Punuese Dragash duke vizituar këto objekte:

Objekti i HRJ në Dragash (Objekt i Administratës), Objektet te Stacioni filtrat (komora mbledhëse me rezervuar), Rezervuarët.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese)

* Gjatë inspektimeve të objekteve në njësinë e Dragashit është vërejtur se aparatet kundër zjarrit nuk kanë qenë të sistemuar në vendin e duhur, kështu që është specifikuar vendi i përshtatshëm për vendosje të aparateve kundër zjarrit.

* Përgatitja dhe dërgimi i raportit të punës nga zyrtari për siguri për muajin Mars dhe për TM-1.

* Gjatë muajit Prill është kontrolluar gjendja e rezervuari në lagjen e Tususit dhe rezervuari i cili gjendet mbi Dardani ku edhe është përshkruar gjendja faktike në raportin e punë.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese).

* Dërgimi i raporteve për gjendjen ekzistuese për objektet në Njësinë Punuese në Dragash dhe për Njësinë Punuese në Prizren.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese)

* Takim me koordinatorin e Komunës së Prizrenit për siguri lidhur me sigurinë e objekteve dhe detyrat dhe përgjegjësit e rojtarëve, takimi kishte karakter informues rreth funksionimit të kësaj shtylle.

* Kontrollimi i vendosjes së aparateve kundër zjarrit tek objekti i vjetër Depot dhe njëherësh është specifikuar edhe vendi i përshtatshëm për vendosjen e aparateve kundër zjarrit.

* Kontrollimi i punëtorëve të Njësisë Operative në Prizren lidhur me sigurinë dhe shëndetin e tyre në punë duke kontrolluar punëtorët për respektimin e masave mbrojtjes në punë, gjatë kontrollimit të punimeve punëtorët kanë respektuar kërkesën e zyrtarit për siguri për përdorimin e helmetave në kokë gjatë zhvillimit të punimeve si dhe janë respektuar mbajtja e uniformes që identifikohen si punëtor të Kompanisë.

* Vizita e objekteve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.: 40 Burimet, Filtrat, Rezervari i Shpatit si dhe depot së bashku me objektet e vjetra që gjenden në hapësirën tek "Mulliri i vjetër".

Kryerja e punëve nga ana e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për muajin Maj, 2016

* Kontrollimi i objekteve në Njësinë e Prizrenit lidhur me mirëmbajtjen e objekteve si dhe pastërtinë e hapësirave për rreth objekteve.

* Përgatitja dhe dërgimi i raportit të punës nga zyrtari për siguri për muajin Prill 2016.

* Gjatë muajit Maj është kontrolluar gjendja e rezervuarit të shpatit, koagulatorët, dhe janë vizituar objektet e Mullirit – Depos dhe është kërkuar nga punëtorët rojtarë të merren më tepër me pastërtinë e hapësirës duke kërkuar të prehën të gjitha shkurret dhe të bëhet prerja e barit.

* Takimit me koordinatorin e sigurisë pran Komunës së Prizrenit lidhur me funksionimin e shtyllës për siguri dhe emergjencë.

* Gjatë muajit Maj është dërguar kërkesa të gjithë menaxherëve të Njësisë dhe menaxherit teknik për të bërë të gjitha paramasat lidhur me nevojat e investimeve në objektet e "Hidroregjionit", të bazuar në raportin e Zyrtarit për Siguri mbi gjendjen e tyre ekzistuese.

* Në angazhimin tim gjatë muajit Maj kam përpiluar Draft-dokument me propozim për formimin e Shërbimit për Siguri dhe Emergjencë me detyrat dhe përgjegjësit e menaxherit për Siguri dhe Emergjencë, Kërkesa i është drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv dhe U.D. të Sekretarit të Kompanisë.

* Kontrollimi i punëtorëve të Njësisë operative në Prizren lidhur me sigurinë dhe shëndetin e tyre në punë duke kontrolluar punëtorët për respektimin e masave mbrojtjes në punë, në vendet e ndryshme ku janë zhvilluar punimet.

* Gjatë kontrollimit të punimeve punëtorët kanë respektuar Kërkesën e zyrtarit për siguri për përdorimin e helmetave në kokë, si dhe mbajtjen e uniformës që identifikohen si punëtorë të "Hidroregjionit Jugor".

* Vizita e objekteve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor: 40Burimet, Rezervari i Shpatit, dhe është kërkuar të ndërhyrjet me përmirësimin e pastërtisë tek këto hapësira.

* Pranimi i aktvendimit nga Inspektorati i Komunës për ndryshimin e zvogëlimit të madhësisë së reklamës me logon dhe emrin e kompanisë që gjendej tek objektet e vjetra mbi objektin e "Hidroregjionit Jugor" në rrugën "Vatrat Shqiptare".

* Punimi i formularit (Procesverbal i Deklaratës) për lëndime në punë i cili duhet të plotësohet për të lënduarin – aksidentuarin gjatë orarit të punës.

Kryerja e punëve nga ana e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për muajin Qershor, 2016

- * Kontrollimi i objekteve në Njësinë e Prizrenit lidhur me mirëmbajtjen e objekteve si dhe pastërtinë e hapësirave për rreth objekteve.
- * Përgatitja dhe dërgimi i raportit të punës nga zyrtari për siguri dhe shëndetin në punë për muajin Maj2016.
- * Gjatë muajit Qershor janë vizituar objektet e Mullirit – Depos dhe është kërkuar nga punëtorët rojtarë të merren më tepër me pastërtinë e hapësirës duke kërkuar të prehën të gjitha shkurret dhe të bëhet prerja e barit.
- * Gjatë këtij muaji kam pranuar njoftimin e inspektoratit për zvogëlimin e madhësisë së reklamës të Hidroregjionit Jugor, te objektet e vjetra me arsyetimin se i kalon përmasat e madhësisë të lejuar nga qendra historike e Prizrenit.
- * Takim me drejtorin e qendrës rajonale për trashëgimi kulturore lidhur me aktvendimin e Inspektoratit Komunal të Prizrenit si dhe biseduam për përmasat e lejuar për vendosjen e reklamës, si dhe kam bërë Kërkesë për tu pajisur me pëlqim nga ky institucion për zvogëlimin e vendosjes së reklamës me logon dhe mbishkrimin e kompanisë të Hidroregjionit Jugor.
- * Gjatë muajit Qershor kam pranuar njoftim nga Menaxheri i Njësisë Suharekë për lëndimin në vendin e punës të punëtorit Vaid Jashari, dhe e kam vizituar dhe kam plotësuar raportin e lëndimit në punë në praninë e tij dhe të mbikëqyrësit .
- * Gjatë kësaj periudhe kam parashtruar kërkesë Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve për nevojat e kompanisë të formohet Shërbimi i veçantë për Siguri dhe Emergjencë duke paraparë detyrat dhe përgjegjësit e këtij shërbimi.
- * Njoftim me shkrim ushtruesit të detyrës të sekretarit dhe Departamentit të Financave për servisimin e aparateve kundër zjarrit, sepse data e skadimit është në këtë muaj, njëherësh është dërguar edhe njoftimi mbi numrin e përgjithshëm të aparateve për servisim.
- * Marrja e pëlqimit nga qendra rajonale për trashëgimi kulturore për lejimin e vendosjes të tabelës me logon dhe mbishkrimin e “Hidroregjionit Jugor” në rrugën “Vatrat Shqiptare” në bazë të madhësisë të lejuar në pëlqim, dhe ky pëlqim është dorëzuar U.D. Sekretarit, Menaxherit Teknik, Menaxherit të Njësisë Prizren si dhe në Arkivit me qëllim që të ndërhyhet në ndryshimin e madhësisë së reklamës

V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR

5.1 Aktivitetet TM2- 2016

Aktivitetet nga shërbimi financiar për TM2 2016 kanë qenë të shumta, disa nga aktivitetet për këtë tre mujor janë këto:

- Regjistrimi i arkave, furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajin përkatës.
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore, si dhe tremujore, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet mujore per ZRRUK

- Pregatitja e raporteve për tremujorin e II-të të 2016, si ato financiare si dhe për ARRU
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, me apo pa kontratë, aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Takime me kryeshefin lidhur me performancat e muajve, Prill – Qershor 2016 si dhe takime me menaxherët e njësive.
- Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave; atë të logjistikës, portoarkave, etj.
- Gjithashtu, kemi pasur edhe angazhim më të madhë në arritjen e normës më të lartë të inkasimit, uljen e shpenzimeve, rritjen e performancës, ku ky tre muaj ka qenë dukshëm më i mirë se sa tremujori i kaluar.

5.2 Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre muajorin e II-të 2016, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të I-rë të vitit 2016, janë dukshëm më të ulta, gjithashtu edhe inkasimi ka qenë më i lartë në krahasim me tremujorin e kaluar, pra nga kjo kemi mbulueshmëria operative më të lartë.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti shpenzimet;

Pozicioni të shpenzimet e pagave, kemi një rritje të shpenzimeve, ngase në këtë tremujor kemi rritje të numrit të punëtorëve, sidomos në Njësinë e Prizrenit. Rritje kemi gati tek të gjitha njësitë, përveq të Njësisë së Dragashit, kemi ulje të shpenzimeve, sepse dy nga punëtorët e kësaj njësie kanë kaluar në Prizren, gjë që ka ndikuar edhe në ulje të shpenzimeve për këtë njësi.

Ndërsa të shpenzimet e energjisë elektrike kemi një zvoglim të shpenzimeve në krahasim me tremujorin paraprak, duke ditur se në tremujorin e dytë të vitit, faturohemi me tarifë verore për energji elektrike. Kjo është një nga arsyt kryesore për ulje të shpenzimeve për këtë kategori.

Edhe të pozicioni i derivateve kemi një zvogëlim të shpenzimeve, por që edhe ky tre muaj ka pasur një trend pothuajse të njejtë me tremujorin e kaluar, ndoshta ulja e shpenzimeve ka ardhur nga ulja e çmimit të derivateve.

Ndërsa të pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve kemi një rritje të shpenzimeve, ngase në këtë tremujor ka qenë nevoja më e madhe në intervenime në rrjet.

Të shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë etj, kemi një rritje të tyre, ngase në këtë tremujor kemi furnizim më të madh të materialit administrative dhe të faturave për konsumator.

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të ulta në krahasim me tremujorin e I-rë të vitit dhe performanca ka qenë dukshëm më e mirë.

Më poshtë do të japim edhe arsyjet më konkrete sipas njësive;

VI RAPORTI I AKTIVITETEVE TE PROKURIMIT – TM2-2016

-Gjatë periudhës Prill-Qershor 2016 në zyrën e prokurimit janë zhvilluar këto aktivitete të prokurimit:

- Gjatë muajit shkurt me dt.18.02.2016 në zyrën e prokurimit ka ardhur një kërkesë nga departamenti teknik inicues i të cilit është Zenel Zenelaj për Furnizim : **Furnizim me pjesë për Rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit në zonat rurale për PZ,SU,MA dhe DR** aprovimi nga bordi është marrë me dt.18.02.2016.Ky aktivitet i prokurimit është publikuar në web të KRPP-së me dt.26.02.2016.Kërkesat për tërheqjen e dosjës së aktivitetit në fjalë kanë qenë 14,ndërsa kanë dorëzuar 3 ofertues.Dorëzimi dhe hapja e ofertave është bërë me dt.17.03.2016 në ora 13-13:30h.Kjo procedur ka vazhduar me vlerësimin e ofertave ,ku kompania NPT “Xerxa” është shpallur fituese e këtij tenderi në vlerë prej:**13,955.00€**.Nënshkrimi i kontratës ndërmjet kompanise fituese NPT “Xerxa” dhe KRU “Hidroregjionit Jugor” është bërë me datë :**04.04.2016**
- Gjatë muajit shkurt me dt.18.02.2016 në zyrën e prokurimit ka ardhur nje kerkese nga menaxheri I njesise se Prizenit inicues I te cilit eshte Shefkat Halimi per sherbimin: **Vinklimi I Elektromotoreve** aprovimi nga bordi eshte marre me dt.**18.02.2016**.Ky aktivitet i prokurimit eshte publikuar ne web te KRPP-se me dt.01.03.2016.Kerkesat per terheqjen e dosjes se aktivitetit ne fjale kane qene 4,ndersa kane dorezuar 3 ofertues.Dorezimi dhe hapja e ofertave eshte bere me dt.21.03.2016 ne ora 13-13:30h.Kjo procedur ka vazhduar me vleresimin e ofertave ,ku kompania NTSH “Vagenn” eshte shpallur e papergjegjshme ndersa DPT “Elektron” eshte shpallur fituese e ketij tenderi ne vlere prej:**19,037.10€**.Nenshkrimi i (**kontrates korniz**) ndermjet kompanise fituese DPT “Elektron” dhe KRU “Hidroregjionit Jugor” eshte bere me date :**13.04.2016**
- Gjatë muajit shkurt me dt.25.02.2016 në zyrën e prokurimit ka ardhur nje kerkese nga zyra per mirmbajtjen e pompave inicues i te cilit eshte Qamil Jonuzi per furnizim : **Furnizim me pomp ate ujite** aprovimi nga bordi eshte marre me dt.**09.03.2016**.Ky aktivitet i prokurimit eshte publikuar ne web te KRPP-se me dt.23.03.2016.Kerkesat per terheqjen e dosjes se aktivitetit ne fjale kane qene 21,ndersa kane dorezuar 2 ofertues.Dorezimi dhe hapja e ofertave eshte bere me dt.13.04.2016 ne ora 13-13:30h.Kjo procedur ka vazhduar me vleresimin e ofertave ,ku kompania NPSH “Hiterm-el” eshte shpallur fituese e ketij tenderi ne vlere prej:**76,969.14€**.Nenshkrimi i (**kontrates korniz**) ndermjet kompanise fituese NPSH “Hiterm-el” dhe KRU “Hidroregjionit Jugor” eshte bere me date : **29.04.2016**.
- Gjatë muajit mars me dt.10.03.2016 në zyrën e prokurimit ka ardhur nje kerkese nga shefi I Autoparkut inicues i te cilit eshte Durmish Shinik per furnizim : **Furnizim me Goma te Automjeteve** aprovimi nga bordi eshte marre me dt.**17.03.2016**.Ky aktivitet i prokurimit eshte publikuar ne web te KRPP-se me dt.15.04.2016.Kerkesat per terheqjen e dosjes se aktivitetit ne fjale kane qene 6.Ky aktivitet i prokurimit eshte anuluar me arsyetimin se ka gabime ne specifikimin e materialit ku jane perseritur disa here materialet e njejta .Anulimi i aktivitetit ne fjale eshte bere publike ne web te KRPP-se me dt.13.04.2016

